

# KODI I SJELLJES NË RBAL

## HYRJE

Kodi i Sjelljes i Grupit RBAL mbështetet në secilin prej nesh në lidhje me pyetjet e mëposhtme:

A i njoh unë vlerat themelore të Raiffeisen?

A është veprimi im i ligjshëm dhe a pajtohet me politikën e Raiffeisen ?

A duket i drejtë veprimi im?

Mundem ta justifikoj veprimin tim në Institucion, apo tek autoritetet kompetente që kanë të bëjnë me çështjet që i përkasin Institucionit?

A mund ta justifikojë veprimin tim në se pyetem më pas për të?

Asnjë Kod Sjellje nuk mund të gërmëzojë sjelljen e duhur për çdo situatë, as nuk duhet të kërkohet që ta bëjë këtë. RBAL mbështetet në secilin prej nesh për të dhënë një gjykim të kujdesshëm dhe të peshuar të asaj që është e drejtë dhe e përshtatshme në çdo situatë të veçantë.

Nëse keni pyetje lidhur me zbatimin e Kodit të Sjelljes ose në qoftë se ka pasiguri mbi pasojat direkte apo indirekte të një transaksioni apo veprimi mbi objektivin që RBAL dëshiron të arrije nëpërmjet politikës së etikës, duhet kërkuar këshillim nga menaxherët tuaj të linjës apo nga Zyra e Perputhshmerise.

## 1. TË PËRGJITHSHME

### 1.1 Vlerat kryesore të Institucioneve Raiffeisen

RZB AG (RZB) është pjesë e grupit Austiak të bankave Raiffeisen. Vlerat kryesore që drejtojnë Institucionet Raiffeisen rrjedhin nga idetë e F. W. Raiffeisen, i cili kuptoi që i gjithë aktiviteti ekonomik duhet të orientohet drejt solidaritetit social, mbështetjes tek vetvetja dhe qëndrueshmërisë.

Institucionet Raiffeisen luajnë një rol të rëndësishëm në tregun Shqiptar. Ne jemi të vendosur në drejtimin e qëndrueshëm të korporatës dhe përgjegjësitë sociale që na lindin. Roli ynë në botën e biznesit karakterizohet nga përgjegjësia ndaj klientëve, punonjësve, aksionerëve si dhe shoqërisë në përgjithësi.

**Kodi i sjelljes dhe administrimit** përcakton vlerat kryesore të Bankës sonë dhe hedh themelet e një kulture korporate që është në përputhje me ligjin dhe që orientohet drejt parimeve etike. Ai siguron që sjellja jonë ndaj marrëdhënies të biznesit dhe çështjeve etike të jetë në përputhje me standardet më të larta, të cilat mbështeten në vlerat e mëposhtme:

- Fokusimi i klientit
- Profesionalizmi
- Cilësia

- Respekti reciprok
- Iniciativa
- Puna në grup
- Integriteti

Kjo përfshin një drejtim të mirë të korporatës.

Përputhshmëria me këto vlera shërben gjithashtu për të ruajtur dhe përmirësuar reputacionin e Bankës.

### 1.2 Objektivi i Kodit

Dispozitat e Kodit të Sjelljes dhe Administrimit aplikohen dhe duhet të respektohen nga të gjithë punonjësit e Institucioneve Raiffeisen në Shqipëri. Ky kod, aplikohet për të gjithë punonjësit e rrjetit të Bankave Raiffeisen apo vetë Raiffeisen Zentral Bank. Për me tepër, të gjithë palët e treta, që veprojnë në emër të RBAL, apo Institucioneve të tjera Raiffeisen, duhet të marrin përsipër të respektojnë dispozitat e këtij kodi.

### 1.3 Përputhshmëria me kodin e sjelljes dhe administrimit të Raiffeisen

Kodi i sjelljes dhe administrimit të Institucioneve Raiffeisen është një set/seri normash që rregullon marrëdhëniet e përditshme të biznesit. Qëllimi për fitim nuk mund të na justifikojë përpara ligjit.

Ne nuk kryejmë transaksione biznesi që bien ndesh me parimet tona edhe sikur këto të kryhen nga konkurentët tanë.

### 1.4 Ligjet vendase dhe Standardet e Raiffeisen Bank sh.a.

Institucionet Raiffeisen respektojnë ligjet dhe rregullat e vendit. Sidoqoftë, ne përpiqemi të veprojmë në përputhje

me standardet më të mira të mundëshme, për të kryer aktivitetet e biznesit. Nëse ligjet vendase dhe stadardet që ne aplikojme janë të ndryshme, do të aplikohet norma që është më e saktë dhe më largpamëse.

### **1.5 Përgjegjësitë**

Bordi Drejtues i Raiffesien Bank sh.a. ka përgjegjësinë kryesore për zbatimin e pergjithshem dhe uniform të Kodit të Sjelljes dhe Administrimit. Përgjegjësia operative për futjen, implementimin dhe zbatimin e plotë të tij, në të gjitha njësitë e RBAL, i takon Drejtorit të Compliance të Raiffeisen Bank sh.a. (pika 1.2). Drejtuesit ekzekutive në Raiffeisen Bank sh.a. përgjigjen për zbatimin dhe përputhshmërinë me KSA të RBAL-së në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë. Të gjithë drejtorët - përfshirë anëtarët e bordit drejtues - e kanë për detyrë të shërbejnë si shembull.

### **1.6 Zbatimi**

Ky Kod Sjellje dhe Administrimi plotësohet nga Manuali i zgjeruar i Perputhshmerise. Ky Manual ilustron parimet bazë të përfshira në KSA, jep informacion të detajuar si është implementuar dhe është vënë në praktikë në marrëdhëniet e përditshme. Si parim, Manuali duhet të merret në konsideratë dhe duhet të shërbeje si bazë ligjore. Në qoftë se ka dyshime, duhet të kërkohet autorizimi i specialistit të perputhshmerisë.

Gjatë zbatimit të KSA, është e nevojshme të parashikohet dhe parandalohet çdo rrezik i dëmtimit të emrit tonë. Në secilin dhe çdonjërin vendim, punonjësi përkatës duhet të

sjellë në mend rrezikun e mundshmëm të transaksionit respektiv që shkakton dëmtim të reputacionit tonë.

### **1.7 Detyrimi për të Raportuar Shkeljet**

Në qoftë se punonjësit e institucioneve Raiffeisen kanë dijeni të shkeljeve materiale të Kodit të Sjelljes, ata duhet ta raportojnë çështjen tek drejtori i linjës, te Drejtuesi i Departamentit të Perputhshmerise dhe PPP apo prane Drejtuesit Departamentit të Perputhshmerise të Grupit, pa vonesë. Punonjësit mund të zgjedhin t'i raportojnë shkeljet tek Specialisti i Perputhshmerise në mënyrë anonime. Të gjitha raportet trajtohen si konfidencialë. Ju sigurojmë se nuk do të pësoni ndonjë disavantazh në karrierë për shkak të raporteve të bëra në mirëbesim.

Raportet mund të bëhen në çdo formë të mundëshme komunikimi, përfshirë raportet e shkruar anonimë.

### **1.8 Sanksionet në rast të Shkeljes së Kodit të Sjelljes së RBAL**

Kodi i Sjelljes së Institucioneve Raiffeisen është pjesë përbërëse e kushteve të përgjithshme të punësimit. Pra, çdo shkelje të ketij kodit mund të ndëshkohet me masa disiplinore, përfshirë edhe mbarimin e marrëdhënies së punësimit pa njoftim paraprak.

## **2 . VENDI I PUNËS DHE MARRËDHËNIET ME KOLEGËT**

### **2.1 Respekti reciprok, ndershmëria dhe integriteti**

Ne respektojmë mendimet e të tjerëve, gjithashtu dinjitetin e tyre personal, privacinë dhe të drejtat individuale. Ne nuk tolerojmë asnjë lloj diskriminimi dhe ngacmimi, si për shembull për shkak të kombësisë, kulturës, besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, orientimit seksual, moshës apo handikapit fizik të personit. Marrja në punë, promovimi dhe vlerësimi i punonjësve bazohen ekskluzivisht në kriterin e orientuar në përmbushjen e detyrës, siç janë arritja e objektivave të miratuar, apo eksperiencia profesionale. Politika e pagës aplikon standarte nderkombëtare dhe mbështet strategjinë e biznesit, interesat, vlerat dhe sunimet afatgjata të Institucionit. Ajo gjithashtu ka në përbërje masa për shmangien e konfliktit të interesave.

## **2.2 Pergjegjësia personale e drejtuesve dhe e punonjesve**

Ne Raiffeisen the gjithë punonjesit duhet te veprojnë me pergjegjesi dhe te mos perfshihen ne sjellje te papershtatshme. Bartja e pergjegjesise i sherben qellimit te mbrojtjes se bankes dhe klienteve te saj.

Per keto arsye detyrat e meposhtme te kontrollit duhet te zbatohen me kujdes te vecante:

- Parimi i 4 – syve
- Kontroll identifikimi
- Perputhshmeria me autoritetet nenshkruese
- Kontrolli i vertetesise dhe besueshmerise se dokumentacionit,
- Perputhshmeria me rregullat e limiteve
- Perputhshmeria me kompetencat personale (te dhena)

## **2.3 Konflikti i Interesit**

Të gjithë punonjësit e Institucioneve Raiffeisen duhet të sigurojnë se interesat e tyre nuk janë në konflikt me detyrat e tyre përballë institucioneve perkatese, apo klientëve të tij. Konflikte të fuqishme interesi mund të shkaktohen si pasojë e lidhjeve të ngushta (personale) ndërmjet punonjeve dhe klienteve, perfaqesuesit e partnereve të biznesit apo punonjesve të tjerë. Ne veçanti, konflikt potencial interesi mund të shkaktohet sidomos në lidhje me dhuratat, ftesat, dhënien e kontratave, dhe transaksionet në instrumentat financiarë. Konflikti i interesit mund të lidhet gjithashtu me korrupsionin, mashtrimin, apo abuzimin në bursë. Këto konflikte duhen raportuar tek Specialisti i Perputhshmërisë, i cili më pas vendos nëse ekziston faktikisht një konflikt interesi dhe çfarë masash janë të nevojshme për t'u ndermarre.

## **3. Mashtrimi**

RBAL nuk toleron praktika mashtrimi të asnjë forme. Ne operojmë me ndershmëri dhe pa u influencuar nga korrupsioni. Nga pale të treta që bëjnë biznes me RBAL presim që të zbatojnë të njëjtat parime. Ne do të procedojmë në mënyrë konsistente kundër çdo lloji veprimi të mbuluar, duke ndermarre masat e duhura ligjore

## **4. MITMARRJA DHE KORRUPSIONI**

### **4.1 Mitmarrja**

Institucionet Raiffeisen nuk tolerojnë asnjë formë mitmarrje dhe korrupsioni. Ne nuk pranojmë apo japim (nuk nxisim) asnjë avantazh të pavend të asnjë lloji, pavarësisht se personi që i ofron, apo

kërkon këto avantazhe punon në sektorin publik apo privat.

#### **4.2 Pagesat për Lehtësira**

As punonjësit e Institucioneve Raiffeisen dhe as personat e tretë që punojnë për këto Institucione nuk japin pagesa për lehtësira. Pagesat për lehtësira janë shuma të vogla parash të dhëna zyrtarëve publik me qëllim që të fitohen apo përshpejtohen shërbimet e këtyre personave, për të cilat gjithkush ka një të drejtë të ligjshme (për shembull, kontrolli i pasaportave, leja doganore).

Përfundime lejohen vetëm në qoftë se interesat që gëzojnë mbrojtje më të madhe ligjore, siç psh. rrezikimi i jetes apo shendetit dhe mënyra e vetme për ta evituar këtë rrezik është që të jepet pagesa përkatëse.

#### **4.3 Mitmarrja Direkte dhe Indirekte me anë të Personave të Tretë**

Institucionet Raiffeisen grumbullojnë me kujdes me anë të përzgjedhjes së kujdesshme komisionerët e biznesit, konsulentët, ndërmjetësit dhe gjithë personat e tretë që veprojnë në interes të këtyre Institucioneve dhe që na mbështesin në bërjen e biznesit. Ne sigurojmë gjithashtu që këta persona të tretë nuk bëjnë mitdhënie, mitmarrje apo pagesa për lehtësira brenda fushës së marrëdhënies së tyre të biznesit me Institucionet Raiffeisen.

#### **4.4 Dhuratat dhe Ftesat**

Shkëmbimi i dhuratave dhe ftesash me vlerë modeste mund të përbëjë një komponent të pranueshëm social për marrëdhënie të sukseshme biznesi. Nga ana tjetër, sidoqoftë, pranimi dhe dhënia

e dhuratave dhe ftesave kanë prirjen të kenë një ndikim jo të përshtatshëm në një marrëdhënie biznesi. Është parimisht i ndaluar pranimi dhe dhënia parave si dhuratë. Të gjitha dhuratat dhe ftesat e tjera janë subjekt i këtyre normave strikte.

#### **4.5 Kontributet për Partitë Politike dhe Personat Politikisht të Ekspozuar**

Bordi drejtues i Raiffeisen Bank sh.a. mund të sanksionojë që kontributet t'u jepen Partive Politike dhe Personave të ekspozuar politikisht në qoftë se janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

1. Kontributet nuk janë në kundërshtim me ndonjë normë ligjore;
2. Kontributet janë brenda masës së zakonshme në shtetin Shqiptar;
3. Kontributet nuk priren të kenë ndonjë ndikim të papërshtatshëm.

Këto kontribute duhet të trajtohen në një mënyrë transparente duke përfshirë edhe Departamentin e Përputhshmërisë në Grup.

#### **4.6 Shpenzimet/llogaritë e shpenzimeve, dhurimet, bamirësitë dhe sponsorizimet**

Kontributet në formën e shpenzimeve, donacioneve, bamirësisë dhe sponsorizimeve nuk mund të jepen me qëllim që të shmangen udhëzimet lidhur me pranimin dhe dhënien e dhuratave, rryshfeteve, pagesave me para të pista, kontributet për partitë politike dhe personat e ekspozuar politikisht dhe dispozitat e mëtejshme të Kodit të

Sjelljes dhe Administrimit të Institucioneve Raiffeisen, por mund të jepen ekskluzivisht për qëllimet e përcaktuara në udhëzimet e Grupit.

## **5.MARRËDHËNIET ME KLIENTËT DHE PARTNERËT E BIZNESIT**

### **5.1 Shërbimi i Klientit**

Ne angazhohemi për një kulturë të veçantë shërbimi, duke u përpjekur të tejkalojë vazhdimisht pritshmëritë e klientit. Ne do të ofrojmë një produkt apo shërbim vetëm në qoftë se ne kemi liçencën dhe specialitetin përkatës po aq sa funksionet ndihmëse të nevojshme/aftësitë në vend dhe se gjithmonë do të ofrojmë shërbimet më të mira të mundëshme në interes të klientëve. Veç kësaj, kur japim rekomandime, sigurohemi që ato të jenë të ndershme e të drejta dhe që klientët janë informuar saktë për rezikun e mundshëm. Këshillimi fals apo çorientues është i papranueshëm nga ana jonë.

### **5.2 Konfidencialiteti**

Institucionet Raiffeisen kane detyrimin ta trajtojnë informacionin e klientit si shumë konfidencial. Si parim nuk ia kalojmë ndonjë të dhënë të klientit palëve të treta. Përjashtimet janë lejuar vetëm në rastin kur një konsumator ka dhënë pëlqimin e tij/saj paraprakisht me shkrim ose në rast se ekzistojnë fakte që përbëjnë një përjashtim të pranuar nga ndalimi i dhënies së informacionit, sidomos përballë autoriteteve mbikqyrëse dhe autoriteteve të sistemit gjyqësor.

### **5.3 Të Njohim Klientët**

Duke njohur klientët tanë, reputacionin dhe pozitën e tyre si dhe natyrën e aktiviteteve të biznesit të tyre, ne duam të arrijmë cilësinë më të mirë të mundëshme të shërbimeve. Ndërkohë që respektojmë vendimet dhe objektivat e investimit të klientëve tanë ne sigurojmë që nuk përfitojmë avantazhe nga praktikat e biznesit të paligjshëm, siç është financimi i terrorizmit, pastrimi i parave, apo mashtrimi. Ne në mënyrë të qëndrueshme kryejmë ekzaminimet e duhura, të kujdesshme dhe kontrollojmë me qëllim që të njohim origjinën e fondeve të klientëve tanë dhe të identifikojmë çdo aktivitet të dyshimtë.

### **5.4 Pastrimi i parave**

Institucionet Financiare dhe të kreditit mund të përdoren për të “pastruar” të ardhurat nga aktivitetet kriminale dhe për të fshehur në këtë mënyrë origjinën e tyre të paligjshme e për t’i rifitur ato në ciklin e biznesit normal. Këto aktivitete shkatërrojnë integritetin e një banke, dëmtojnë reputacionin e saj dhe mund ta ekspozojnë bankën ndaj penalizimeve të ashpra. Institucionet Raiffeisen mbështetin përpjekjet ndërkombëtare kundër pastrimit të parave dhe zbaton masa jashtëzakonisht të forta parandaluese dhe të justifikueshme.

## **6. ABUZIMI NË TREG**

### **6.1 Spekulum me Informacionin e Brendshëm**

Spekulimi me informacionin e brendshëm përfshin përdorimin e

papërshtatshëm të informacionit të papublikuar, me ndikim në çmim, për përfitime personale apo në interes të personave të tretë, në rastet e marrveshjeve mbi letrat me vlere, aksioneve apo kuotave. Spekulimi me informacionin e brendshëm ka pasoja direkte penale dhe disiplinore.

## **6.2 Konkurenca e Ndershme**

Abuzimi me pozitën si pjesëmarrës në tregun profesionist ndikon mbi besueshmërinë në funksionimin e tregjeve të kapitalit dhe ka pasoja të rënda për Raiffeisen Bank sh.a. si dhe për çdo punonjës të përfshirë në këto aktivitete. Kërkesa e integritetit zbatohet gjithashtu në betejën për ndarjen e pjesëve të tregut. Ne nuk hyjmë në asnjë marrëveshje verbale të palejueshme dhe pajtohemi me të gjitha normat e konkurrencës së ndershme dhe me normat që rregullojnë sjelljen në treg që janë të zakonshme në një treg të nivelit ndërkombëtar (MiFID).

## **7. KONTABILITETI DHE FINANCA**

### **7.1 Kontabiliteti dhe Raportimi**

Në procesin e tyre vendim-marrës, Institucionet Raiffeisen bazohen në korrektësinë dhe saktësinë e regjistrimit të llogarive. Në këtë kontekst, ka rëndësi të veçantë që siguria dhe të dhënat e stafit po ashtu si të dhënat e kontabilitetit dhe të dhënat financiare të trajtohen si konfidenciale. Të gjitha transaksionet e biznesit duhet të raportohen në librat tanë të llogarisë, në përputhje me procedurat specifike dhe parimet e verifikimit e në pajtim me parimet e kontabilitetit të pranuar përgjithësisht.

Këto regjistrime përmbajnë informacionin e nevojshëm për transaksionet përkatëse.

### **7.2 Detyrimi për prezantimin e te dhenave**

Institucionet Raiffeisen marrin përsipër të vënë në dispozicion të autoriteteve mbikqyrese dhe publikut, të dhëna të plota, të ndershme dhe të kuptueshme, brenda fushës së detyrimeve tona. Zbulimi i të dhënave tona financiare i korrespondon standardeve aktuale në këtë industri.

### **7.3 Bashkëpunimi me autoritetet Mbikqyrese**

Ne marrim përsipër që marrëdhëniet tona me autoritetet mbikqyrese përkatëse për Raiffeisen Bank sh.a. të jenë të hapura, transparente dhe bashkëpunuese. Qëllimi ynë është të zhvillojmë marrëdhëniet midis Raiffeisen Bank sh.a. dhe autoriteteve, të cilat janë bazuar në besimin dhe konfidencën.

## **8 FUSHAT E NDJESHME TË BIZNESIT**

### **8.1 Të Drejtat e Njeriut**

Institucionet Raiffeisen nuk do të financojnë qoftë direkt apo indirekt ndonjë transaksion, projekt apo palë që përfshihen, ose përfshiheshin në përdorimin e punës së detyruar (përfshirë punën me kontratë) apo punën e fëmijëve, ose kur

- Shkel Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut;

- Shkel detyrimet sipas të Drejtës së Punës dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë;
- Shkel normat e zbatueshme të nxjerra nga organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë pa ndonjë kufizim Konventat korresponduese të Kombeve të Bashkuara; apo
- Shkel të drejtat e popullsisë lokale apo banorëve vendas.

Ne nuk përfshihemi në biznese ku produktet mund të perdoren për shtypjen e demonstratave, trazirave politike apo shkelje të tjera të drejtave të njeriut. Keto aplikohen veçanërisht në vendet ku trazira politike apo konflikte ushtarake po zhvillohen apo priten të zhvillohen.

### **8.2 Ambienti**

Financimi apo pjesëmarrja në ndonjë transaksion dhe /ose projekte, të cilat vënë në rrezik ambientin me pasojë të përhershme (për shembull: shkatërrimi i pyjeve tropikale, ndotja e mjedisit dhe e ujrave), nuk janë në përputhje me politikën e biznesit të Institucioneve Raiffeisen.

Në çdo vendim, punonjësi përkatës duhet të mbaje mend rrezikun e mundshëm të dëmtimit të reputacionit të Raiffeisen, i cili mund të shkaktohet nga çdo transaksion apo projekt që mund të ketë ndikime negtative mbi ambientin. Për më tepër, duhet treguar kujdes për të siguruar që ndërmarrja që merr financimin i përdor fondet në përputhje me

- Dispozitat vendase për mbrojtjen mjedisore,
- Dispozitat e BE-së për mbrojtjen mjedisore dhe
- Konventat ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e mjedisit

që janë të detyrueshme herë pas here.

Në qoftë se ka pasiguri për efektet direkte apo indirekte të një transaksioni që do të kryhet, duhet të kërkoni këshillim nga specialisti i përputhshmerisë.

### **8.3 Fuqia Atomike**

Ne nuk marrim pjesë në ndertimin e një impianti atomik dhe as bejme biznes me impiante atomike apo operatorët e tyre. Eksperiencat me të fundit tregojnë se rreziku i që impiantet atomike mund t'i shkaktojnë mjedisit dhe qenieve njerezore janë aktualisht të pamënaxhueshme.

### **8.4 Armatimi/ Materiale Luftë**

Ne nuk marrim pjesë në biznese të lidhura me arme luftarake dhe mjete të tjera ushtarake (përfshirë pajisjet e perorura për shtypje të brendshme ose agresion drejt vendeve të tjera) me vendet që kanë aktualisht konflikte ushtarake apo trazira politike.

Raiffeisen Bank sh.a. nuk investon në kompani që prodhojnë pajisje ushtarake dhe arme.

### **8.5 Kufizimet e Tregëtisë dhe Sanksionet**

Institucionet Raiffeisen mbështeten në specifikimet ndërkombëtare për sa i përket embargove dhe kufizimeve të tregëtisë. Në raste sensitive rragulla me strikte mund të zbatohen si në rastet e Iran-it dhe Korese së Veriut.



## ***8.6 Biznesi ne industrine e lojrave***

Biznesi me kompani qe operojne ne fuhsen e lojrave eshte i mundur vetem nese garantohet qe nuk do te kete shkelje te kuadrit ligjor te aplikueshem. Aplikimi i rregullave te huaja apo kerkimi i licencave te huaja kerkon vemendje te vecante.

## ***8.7 Marrëdhëniet e Ndaluarat të Biznesit***

Institucionet Raiffeisen nuk mbajne marrëdhënie klientele me bankat guacke.